



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:014776

Datë: 18.10.2019

Numri i dokumentit: 00586808

P.nr.393/16

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me Sek. Juridike Vjollca Bytyqi, ne lenden penale PP.II.nr 661-7/16 të datës 16.05.2016, ndaj të pandehurit H. B. nga fsh. G. komuna Suharekë, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës nga neni 332 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në prezencë të prokurorit te PTH-së nga Prizreni Sahide Sefa dhe te akuzuarit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, te mbajtur me dt.09.10.2019 mori publikisht shpalli dhe me date 17.10.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit H. B., nga i ati B., e ëma N., e lindur S., i lindur me dt., nga fsh. G., komuna Suharekë, ku dhe tani jeton, i martuar, baba i 6 fëmijëve, invalid, din shkrim lexim, i gjendjes jo të mirë ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës. me numër personal

Konform nenit 363 par. 1 pika 1 e KPP-së

REFUZOHET AKUZA

Sepse prej datës se pa vërtetuar deri me date 28.02.2016, ne zonën katastrale ne fshatin Mushtisht ne ngastrën katastrale P-72116001100015-0 OTHPB ekonomia e pyjeve Biraq, ne mënyrë te kundërligjshme ka uzurpuar pronën publike sipërfaqen pyjore prej 1 ha, te autoritetit pyjor Komunal ne Suhareke.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm pronës se paluajtshme nga neni 332 par. 2 nen par. 1 te Kodit Penal.

Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

PTH. në Prizreni me aktakuzën **PP.II.nr 661-7/16 të datës 16.05.2016**, ndaj të pandehurit H. B. nga fsh. G. komuna Suharekë, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës nga neni 332 par. 1 i Kodit Penal, aktakuzën të cilën gjate seancës gjyqësore e ka përfaqësuar PSH ne Prizren Sahide Sefa.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të dates **09.10.2019** në fjalën e vet përfundimtare prokurori i shtetit Sahide Sefa deklaroi se terhiqem nga akuza **PP.nr.661-7/2016 te dt .16.05.2016** e parashtruar ndaj te pandehurit H. B., meqense gjate administrimit te provave me asnje prove, nuk eshte vertetuar se i njejt i ka kryer veper penale uzurpim i paligjshëm i pronës nga neni 332 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës,

Gjykata, pas tërheqjes së prokurorit nga akuza, përkatësisht nga ndjekja e mëtejme penale ndaj të pandehurit H. B., për veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës nga neni 332 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP, morri aktgjykim refuzues.

Vendimin për lirimin nga shpenzimet gjyqësore, gjykata e mori në bazë të nenit 454 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë dhe në baz të nenit 363 par 1 nën par.1.1 të KPP, u vendos sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.